

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I FARMACISTËVE
KËSHILLI KOMBËTAR

Nr ____ Prot.

Tiranë, më __/__/2016

Drejtuar : Z. Alfred Çareri

Sekretari i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 1, Tiranë

Lënda: Veprimtaria e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë për periudhën Korrik- Dhjetor 2015

Urdhri I Farmacistëve të Shqipërisë ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, ushtrimin e profesionit sipas kërkesave shkencore, të normave të etikës mjekësore e të Kodit të Deontologjisë Farmaceutike Shqiptare dhe mbrojtjen e pacientëve e të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme. Ashtu sikurse dhe vitet e tjera, gjatë vitit 2015, veprimtaria institucionale e UFSH ka qenë e përqëndruar në përmbushjen e misionit që vet ligji I ngarkon duke u angazhuar maksimalisht në bashkëpunimin me institucionet e tjera për hartimin dhe planifikimin e programeve të formimit shkencor, të specializimit pasuniversitar dhe të kualifikimit të vazhdueshëm të farmacistëve, në mbikëqyrjen dhe zbatimin e detyrave profesionale të farmacistëve në përputhje me legjislacionin farmaceutik dhe në zbatim të kodit deontologjik, në regjistrimin dhe kryerjen e praktikës profesionale të farmacistëve si dhe në regjistrimin e studentëve për provimin e shtetit përgjatë dy sezoneve, si dhe në regjistrimin e farmacistëve dhe dhënien e të drejtës së ushtrimit të profesionit.

Po ashtu gjatë këtij viti Urdhri I Farmacistëve është përballur dhe me procesin e ciklit të parë të ricertifikimit të farmacistëve në të gjithë Republikën e Shqipërisë, proces I cili u mbyll me sukses të plotë e për të cilin ju kemi vënë në dijeni dhe në raportin e dërguar në muajin shtator 2015 ku gjendet i pasqyruar dhe raporti për 6 mujorin e parë të veprimtarisë së UFSH.

Gjatë periudhës korrik- dhjetor 2015, pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë janë bërë gjithsej 90 anëtarësime të reja, sipas listës të bashkëngjitur këtij raporti.

Gjatë kësaj periudhe, që nga korriku 2015 deri ne dhjetor është vazhduar me procesin e ricertifikimit për ata farmacistë të cilët kanë aplikuar më vonë. Në total numri i farmacistëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e ricertifikimit dhe që janë aktivë shënon 2200 farmacistë, nga të cilët 1145 farmacistë në rajonin e Tiranës dhe 1055 farmacistë në rajonet e tjera të vendit.

Një nga problematikat me të cilat është hasur sektori i regjistrimit pranë UFSH-së, sidomos pas periudhës Qershor 2015, është fakti se ndihmës farmacistët të cilët e ushtrojnë profesionin në farmaci, nuk mund të ricertifikohen për shkak se Ligji i ri i Barnave e ka përjashtuar këtë kategori dhe nga moment i hyrjes në fuqi të Ligjit dhe deri më sot nuk ka asnjë akt tjetër nënligjor që të përcaktojë sesi do të procedohet me këtë kategori. Urdhri i Farmacistëve e ka ngritur këtë shqetësim pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe me anë të shkresës Nr. 1032 Prot , datë 23.12.2015, i ka vënë në dispozicion Ministrisë listën me emrat e ndihmës farmacistëve që ushtrojnë profesionin në farmaci, por edhe sot e kësaj dite jemi në pritje të një përgjigje për ti dhënë zgjidhje këtij vakumi ligjor, i cili nuk është në kompetencë të UFSH- së.

Po ashtu një pike tjetër që prek kategorinë e ndihmës farmacistëve, që gjithashtu është ngritur si shqetësim nga UFSH pranë Ministrisë me anë të shkresës Nr. 812 Prot , datë 28.10.2015, është përcaktimi se kush do të trajtohet si zona rurale në kuptim të Ligjit të Barnave referuar Ligjit për ndarjen e Re Administrative Territoriale. Ky përcaktim lidhet drejtpërdrejtë me kriteret e certifikimit të ndihmes farmacistëve, pasi referuar Ligjit Nr.105/2014 “Për Barnat dhe Shërbimit Farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, agjensitë farmaceutike hapen vetëm në zona rurale ku nuk ka farmaci. Këto dy problematika, të cilat janë ngritur si shqetësim nga UFSH kanë sjellë një ngërc pranë zyrës së regjistrimit pasi UFSH nuk ka një reference ligjore ku të bazohet për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit, ndihmës farmacistëve të prekur nga këto ndryshime ligjore.

Neni 7 i Ligjit Nr.9150 datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndonëse na ngarkon me përgjegjësi për të vënë në dijeni cdo 6 muaj Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me problematika me interes të ndërsjelltë e ndonëse Urdhri i Farmacistëve

të Shqipërisë në mënyrë të vazhdueshme ka vënë në dijeni Ministrinë e Shëndetësisë për problematika të hasura gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet (referuar shkresave të sipërpërmendura por jo vetëm), nga ana e ministrisë asnjëherë nuk ka gjetur frymën e bashkëpunimit, shprehur kjo me mungesën absolute të një përgjigje për të qenë në pritje të zgjidhjes së problemit, pavarësisht parashikimeve të afateve të përcaktuara në ligjin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për trajtimin e kërkesave për informim nga autoriteti publik.

Duke shpresuar që nga ana e Ministrisë, UFSH të shihet si një partner në rregullimin e problematikave që has sistemi farmaceutik, vlerësojmë si domosdoshmëri që Ministria e Shëndetësisë të ushtrojë kompetencat e saj në mënyrë që rezultati të jetë pozitiv.

Në vijim bashkangjitur po iu dërgojmë dhe listën e të gjithë anëtarëve aktivë të UFSH si dhe të dhënat e tyre përkatëse aq sa ne disponojmë.

PRESIDENTE

Diana Toma